

Përmbajtja

1. Ligji Nr. 8756 , datë 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile”	01
2. Vendim Nr. 206 , datë 26.03.1998 , “Për Kriteret per Pjesemarrjen e Shtetit ne Perballimin e Demeve ne Rast Fatkeqesisht”	13
3. Vendim Nr. 654 , datë 18.12.2002 , “Për Përcaktimin e Tarifave Për Përdorim të Përkohshëm nga Organet Shtetërore, në Situata Emergjente, të Çdo Mjeti Privat”	16
4. Vendim Nr. 655 , datë 18.12.2002 “Për Ngritjen dhe Funksonimin e Strukturës së Sistemit Kombëtar të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile”	20
5. Vendim Nr. 663 , datë 18.12.2002 “Për Përbërjen, Funksonimin dhe Përgjegjësitë e Komisionit Teknik Këshillimor të Specialistëve për Emergjencat Civile”	26
6. Vendim Nr. 664 , datë 18.02.2002 “Për Kriteret dhe Procedurat e Shpalljes së Gjendjes së Emergjences Civile”	29
7. Vendim Nr. 531 , datë 01.08. 2003 “Për Organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile”	31
8. Vendim Nr. 532 , datë 01.08.2003 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Departamentit të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile”	36
9. Vendim Nr. 533 , datë 01.08.2003 “Për Pjesëmarrjen e Shtetasve në Parandalimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile”	38
10. Udhezim Nr. 3 , datë 04.03.2003 “Për Kriteret e Përzgjedhjes së Personelit të Strukturave të Emergjencave Civile”	40
11. Udhezim Nr. 15 , datë 10.07.2003 “Për Ngritjen e Komisionit Vendor të Emergjencave Civile, në Bashki dhe Komunë”	42
12. Udhezim Nr. 16 , Datë 11.07.2003 “Për Ngritjen e Komisionit të Planifikimit të Emergjencave Civile në Nivel Qarku	44



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr. 8756, datë 26.3.2001

PËR EMERGJENCAT CIVILE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 170 dhe 174 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Planizimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar që synon:

- a) Parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;**
- b) Sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;**
- c) Garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.**

Neni 2 Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "**Emergjencë civile**" kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.
2. "**Emergjencë civile kombëtare**" kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohshme, që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetasve të Republikës së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të qeverisjes vendore për ta përballuar atë, ose kërcënon seriozisht mundësinë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.
3. "**Fatkeqësi natyrore**" kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësitrat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.
4. "**Fatkeqësi të tjera**" kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.
5. "**Fatkeqësi**" kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera të parashikuara në këtë ligj, të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore e materiale-teknike.
6. "**Masa mbrojtëse**" kuptohen masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.
7. "**Operacion ndërhyrjeje**" kuptohen veprimet e forcave dhe të mjeteve, për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.
8. "**Parandalim**" kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shangien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.
9. "**Parashikim**" kuptohen veprimtaritë që kryen për studimin dhe përcaktimin e shkaqeve të emergjencave, për përcaktimin e zonave, të territoreve dhe objekteve nga rreziqet e njëjta.

10. "**Planizim e përballim të emergjencave civile**" kuptohet përgatitja e autoriteteve publike, e institucioneve dhe organeve të qeverisjes qendrore e vendore, e personave juridikë, publikë ose privatë, e organizatave publike dhe e populltës për një emergjencë civile, si dhe për rastet e një fatkeqësie natyrore, duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente.
11. "**Riaftësim**" kuptohen masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme në rajonin (territorin) e prekur nga fatkeqësia.
12. "**Rrezik**" kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
13. "**Shërbim të emergjencave civile**" kuptohet shërbimi i bashkërenduar i Policisë së Shtetit dhe të gjitha policive të tjera, shërbimi i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri dhe i urgjencës mjekësore.
14. "**Vlerësim rreziku**" kuptohet analiza sasiore e cilësore e natyrës dhe e rrethanave të tjera për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. **Organet shtetërore, të përcaktuara në këtë ligj, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia.**
2. **Organet shtetërore kanë të drejtë të përdorin çdo mjet publik ose privat, si dhe të bashkëpunojnë me organizata vullnetare që kanë rol të përcaktuar në situatat emergjente, për të shmangur ose për të reduktuar pasojat që shkaktohen nga fatkeqësitë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për aq kohë sa vepron rrethana që i ka shkaktuar ato pasoja.**
3. **Strukturat e ngritura për planizimin dhe për përballimin e emergjencave civile funksionojnë si të tilla edhe në rastet kur me ligj shpallet gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e luftës ose gjendja e fatkeqësisë natyrore, duke pasur si qëllim kryesor marrjen e masave për parandalimin dhe riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e luftës ose gjendja e fatkeqësisë natyrore.**
4. **Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me mundësitë e tij reale, ka për detyrë të ndihmojë në parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave që shkaktohen nga fatkeqësitë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.**
5. **Asnjë organ, i përcaktuar në këtë ligj, nuk mund të ushtrojë përgjegjësi që nuk janë në sferën e veprimtarisë së tij.**

6. **Organet që, sipas këtij ligji, ngrihen për situata emergjente, janë fuqiplote, brenda përgjegjësi dhe hierarkisë së tyre dhe veprojnë edhe pas kapërcimit të situatave emergjente, siç përcaktohet në pikat 1 dhe 2 të nenit 174 të Kushtetutës.**
7. **Organet, që sipas këtij ligji kanë natyrë operative, funksionojnë në mënyrë të përhershme dhe kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë ligj për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes dhe për riaftësimin e pasojave nga fatkeqësitë.**
8. **Aktet e organeve më të larta janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga organet më të ulta dhe nga çdo person fizik ose juridik. Ato marrin fuqi juridike në çastin e nxjerrjes së tyre. Organet që i nxjerrin këto akte detyrohen t'i vënë ato menjëherë në dispozicion të zbatuesve.**

**Neni 4
Llojet e strukturave**

Për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile krijohen struktura mbi baza të përkohshme dhe të përhershme në nivel qendror dhe vendor.

KREU II

STRUKTURAT E PLANIZIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË NIVEL QENDROR

**Neni 5
Këshilli i Ministrave**

1. **Këshilli i Ministrave është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë.**
2. **Në ushtrimin e funksioneve të tij për këtë qëllim, Këshilli i Ministrave kryen këto detyra:**
 - a) **Miraton politikën dhe programet për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.**
 - b) **Miraton programin kombëtar dhe krijon kushte për arsimimin, trajnimin, planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.**
 - c) **Vendos për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes ose riaftësimin e pasojave të situatave të emergjencës civile.**
 - d) **Informon Presidentin dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për emergjencën civile, për pasojat që vijnë, si dhe për masat e marra për shmangien e saj.**
 - e) **Kërkon pëlqimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.**

- f) Vlerëson nivelin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, në bashkëpunim me specialistët e organeve përgjegjëse, si dhe asistencën për riaftësim.
- g) Përcakton, në bashkëpunim me donatorët e huaj, procedurat për asistencën ndërkombëtare në rastet e emergjencave civile, në përputhje me konventën përkatëse ndërkombëtare të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare.
- h) Planifikon fonde për mjete e pajisje rezervë të shtetit për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Neni 6

Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile

1. Për çdo rast të një emergjence civile kombëtare, sipas qëllimit dhe objektit të këtij ligji, pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile.
2. Këshilli i Ministrave përcakton kryetarin e këtij Komiteti dhe përbërjen e tij.
3. Komiteti Ndërministror qëndron i mbledhur deri në shuarjen e shkaqeve që kanë çuar në emergjencë.
4. Komiteti Ndërministror mund të thërrasë specialistë për këshillime në emergjenca.

Neni 7

Detyrat e Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile

Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile kryen këto detyra:

- a) Bashkërendon veprimet e forcave të shërbimit të emergjencave civile.
- b) Bashkërendon menaxhimin e rezervave shtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre.
- c) Përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare në rast emergjence.
- d) Diskuton dhe vendos paraprakisht për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
- e) Vlerëson rindërtimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për të parandaluar dëmet e mundshme në të ardhmen dhe në sigurimin e kushteve bazë të jetesës.
- f) Në rastet e një emergjence civile kombëtare cakton drejtuesin e operacionit për menaxhimin e saj.
- g) Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe detyra të veçanta, të caktuara nga Këshilli i Ministrave për përballimin e emergjencës civile.

Ministria e Pushtetit Vendor

1. **Ministria e Pushtetit Vendor është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.**
2. **Ministria e Pushtetit Vendor kryen këto detyra:**
 - a) **Zbaton së bashku me institucionet e tjera politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.**
 - b) **Bashkërendon veprimet e të gjitha palëve në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile për përmbushjen e detyrave që u përkasin atyre dhe bashkërendon punët me organet e qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave civile.**
 - c) **Organizon marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillimin dhe zbatimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.**
 - d) **Menaxhon sistemin e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.**
 - e) **Zhvillon strategjitë e programeve të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe i paraqet ato për miratim në Këshillin e Ministrave.**
 - f) **Përpunon zbatimin e programeve të arsimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.**
 - g) **Në bashkëpunim me ministritë, institucionet dhe entet e ndryshme të vendit bën vlerësimin e rreziqeve mbi të cilat bazohet plani kombëtar i emergjencave civile dhe e paraqet atë për miratim në Këshillin e Ministrave.**
 - h) **Merr masa për sensibilizimin e opinionit publik dhe për ndërgjegjësimin e tij rreth emergjencave civile dhe planifikon fonde për studime nga institucionet publike për përballimin e emergjencave civile.**
 - i) **Lidh marrëveshje me shoqata dhe organizata që ofrojnë asistencën e tyre në realizimin e detyrave në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.**
 - j) **Njofton në çdo gjashtë muaj Këshillin e Ministrave për gjendjen e përgjithshme të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.**
 - k) **I siguron Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile të gjitha të dhënat e nevojshme për situatat emergjente dhe për rreziqet që ato përfaqësojnë.**
 - l) **Ndjek punën për krijimin dhe përdorimin e rezervave shtetërore të vëna në dispozicion nga strukturat e rezervave të shtetit, për situatat e emergjencës civile.**
 - m) **Përcakton rregullat e përdorimit të burimeve materiale e financiare në rastet e emregjencës civile.**
 - n) **Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e emergjencës civile.**

- o) Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencës civile.**
- p) Bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.**
- q) Kontrollon zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese në rastet e emergjencave civile.**
- r) Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe nga ligje të tjera.**

Neni 9

Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile

- 1. Në Ministrinë e Pushtetit Vendor krijohet dhe funksionon Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.**
- 2. Departamenti ka për detyrë përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile.**
- 3. Departamenti bën inspektim të vazhdueshëm për zbatimin e masave mbrojtëse kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.**
- 4. Struktura, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.**

Neni 10

Komisioni Teknik Këshillimor i specialistëve

- 1. Pranë Departamentit Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile krijohet Komisioni Teknik Këshillimor me specialistë nga ministritë, institucionet, entet e ndryshme dhe forcat operacionale.**
- 2. Komisioni Këshillimor thirret dhe kryesohet nga Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile.**
- 3. Komisioni kryen bashkërendimin e veprimeve në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile ndërmjet autoriteteve të ndryshme dhe organizatave vullnetare.**
- 4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor, përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni.**
- 5. Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile mban regjistër për specialistët që mund të thërrasë për këshillime.**

Neni 11 Ministritë

- 1. Çdo ministër është përgjegjës për organizimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në veprimtarinë që ka në përgjegjësi.**
- 2. Ministritë kryejnë këto detyra:**
 - a) Hartojnë planet për përgatitjen për emergjencë civile sipas llojit të veprimtarisë dhe të përgjegjesisë të tyre dhe i paraqesin këto në Ministrinë e Pushtetit Vendor për bashkërendim.**
 - b) Zbatojnë planet dhe përcaktojnë masat për parandalimin e fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe të pasojave nga fatkeqësi të tilla në fushën e përgjegjesisë së tyre.**
 - c) Organizojnë trajnimin dhe arsimimin në fushën e veprimtarisë së tyre, në bashkërendim dhe këshillim me Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile.**
 - d) Analizojnë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në fushën e përgjegjesisë së tyre dhe njoftojnë Departamentin e Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.**

Neni 12 Entet e ndryshme publike

- 1. Entet e ndryshme publike, kur u kërkohet nga Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, kryejnë studime të cilat përfshijnë parashikimin, parandalimin dhe shmangien e pasojave të fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe ia paraqesin këto studime këtij Departamenti.**
- 2. Entet publike paraqesin te ky Departament edhe rezultatet e studimeve që mund të jenë me interes për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në përgjithësi.**
- 3. Mënyra e planifikimit dhe e përballimit të kostos përkatëse përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.**

KREU III

STRUKTURAT E PLANIZIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË NIVEL QARKU, BASHKIE DHE KOMUNE

Neni 13 Prefekti

- 1. Prefekti është përgjegjës për planizimin e emergjencave civile në qarkun përkatës.**
- 2. Prefekti ka për detyrë:**
 - a) Të organizojë dhe të bashkërendojë punën për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;**

- b) Të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe komunat për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;
- c) Të ndjekë dhe të kërkojë nga organet vartëse skemat e lajmërimit dhe të funksionimit të tyre;
- d) Të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, për sistemimin e popullsisë në raste emergjence nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
- e) Të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale;
- f) Të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;
- g) Të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
- h) Të analizojë gjendjen e planizimit të emergjencave civile dhe të njoftojë Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile për emergjencat civile që ndodhin në qark;
- i) Të paraqesë kërkesë për ndihmë në qarqet fqinjë dhe në instancat qendrore nëse është e nevojshme.
- j) Të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij.

Neni 14 **Organizimi në qark**

1. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit, ngrihet një komision i qarkut me detyrë bashkërendimin e veprimtarive të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare.
2. Ministri i Pushtetit Vendor përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni.
3. Prefekti mban regjistër për specialistët në qark, me të cilët ai këshillohet kur gjykohet e nevojshme.

Neni 15 **Shërbimi i emergjencës civile**

1. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit, funksionon shërbimi i emergjencës civile, si pjesë përbërëse e sistemit të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile, në përputhje me përcaktimin e pikës 13 të nenit 2 të këtij ligji.
2. Rregullat, mënyra e funksionimit, të drejtat dhe detyrat, si dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencës civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 16

Organizimi në bashki dhe në komunë

- 1. Kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashkinë dhe në komunën përkatëse.**
- 2. Kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës ka për detyrë:**
 - a) Të drejtojë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë dhe në komunën përkatëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;**
 - b) Të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë dhe komunës për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;**
 - c) Të organizojë sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit;**
 - d) Të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme për sistemimin e popullatës në raste të emergjencës nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera;**
 - e) Të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale;**
 - f) Të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;**
 - g) Të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;**
 - h) Të paraqesë kërkesë për ndihmë në bashkitë dhe komunat fqinje e në qark, nëse është e nevojshme;**
 - i) Të analizojë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencës civile në bashki dhe komunë dhe të njoftojë në qark.**
 - j) Të zbatojë detyrat e caktuara nga strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror;**
 - k) Të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile në territorin e bashkisë ose të komunës.**

Neni 17

Komisioni vendor për emergjencat civile pranë bashkisë ose komunës

- 1. Në çdo bashki ose komunë, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë ose të komunës, krijohet komisioni vendor për emergjencat civile me detyrë bashkërendimin e veprimeve të autoriteteve të bashkisë ose komunës dhe organizatave vullnetare për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e vet.**
- 2. Ministri i Pushtetit Vendor përcakton kriteret për përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij komisioni.**
- 3. Kryetari i bashkisë ose të komunës mban regjistër për specialistët në territorin e bashkisë ose komunës, me të cilin këshillohet kur është e nevojshme.**

KREU IV

FORCAT E NDËRHYRJES

Neni 18

Strukturat operative të emergjencës civile

Organizimi i planizimit dhe i përballimit të emergjencave civile përfshin Shërbimin e Emergjencave Civile, Bazën e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, lloje të tjera të policisë së krijuara me ligj në varësi të emergjencës civile dhe organe të tjera të paparashikuara në këtë ligj, por që përfshihen në planet e emergjencave civile.

Neni 19

Baza e Mbrojtjes Civile

Në nivel kombëtar funksionon Baza e Mbrojtjes Civile si strukturë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo përdoret për shpëtimitet e posaçme dhe operacionet e tjera urgjente si përforcim dhe për të siguruar një përgjigje të menjëhershme në emergjencat civile.

Neni 20

Përdorimi i Forcave të Armatosura për emergjencat civile

- 1. Kur shtrirja e një emergjence civile rritet në mënyrë të menjëhershme në ndihmë të operacioneve të shpëtimit dhe të lehtësimit në zonën e fatkeqësisë, me miratim të Kryeministrit ose të Ministrit të Mbrojtjes, mund të përdoren njësi të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas planeve të hartuara më parë në bashkëveprim me komandantët e tyre.**
- 2. Kur njësitë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në operacione, ato drejtohen nga komandantët e tyre sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.**

Neni 21

Policia e Shtetit

- 1. Policia e Shtetit organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit sipas planeve të hartuara më parë.**
- 2. Detyrat e saj përfshin mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe të vdekurve, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".**
- 3. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit, forcat e saj komandohen nga eprorët e tyre, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.**

Neni 22

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi është pjesë përbërëse e forcave operacionale në gatishmëri të përhershme dhe vepron për shuarjen e zjarreve, për kërkimin dhe shpëtimin e njerëzve në zonat e emergjencës civile dhe për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësi të natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 23

Shërbimi i ambulancës

Shërbimi i ambulancës është pjesë përbërëse e forcave operacionale dhe vepron për dhënien e ndihmës së parë në zonën e emergjencës civile dhe për transportimin e të dëmtuarve për në qendrat spitalore.

Neni 24

Shërbimi vullnetar

- 1. Për përballimin e emergjencave civile organizohen dhe veprojnë shërbimet vullnetare.**
- 2. Vullnetar mund të jetë çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, që ka kryer arsimin dhe trajnimin bazë në përgjigje të situatave të emergjencës ose pranon të marrë pjesë vullnetarisht për përballimin e emergjencës civile.**
- 3. Për përballimin e emergjencave civile pranohen vullnetarë edhe shtetas të huaj.**
- 4. Personat që vullnetarisht kërkojnë të marrin pjesë në operacionet e shpëtimit kanë këto të drejta:**

- a) **Ruhet e vendi i punës.**
- b) **Marrin pagesën e plotë nga punëdhënësi, qoftë ky edhe subjekt privat.**

- c) **Në rast aksidenti ose humbjeje jete gjatë veprimtarisë në emergjencat civile përfitojnë pension invaliditeti, sipas dispozitave në fuqi.**

Neni 25
Bashkërendimi i ndihmave

Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile bashkërendon ndihmat nga organizatat ndërkombëtare, nga organizatat joqeveritare dhe nga organizatat private vullnetare vendase dhe të huaja për përballimin e emergjencave civile.

KREU V

SUBJEKTET QË PËRFSHIHEN NË PLANIZIMIN DHE PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Neni 26
Detyrimi i shtetasve

- 1. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e Kushtetutës, detyrohet të marrë pjesë përballimin e emergjencave civile sipas një kërkesë të Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, të prefektit, të kryetarit të bashkisë ose të kryetarit të komunës.**
- 2. Detyrimi për të marrë pjesë në përballimin e emergjencave civile fillon në moshën 18 vjeç dhe përfundon në moshën 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë.**

Neni 27
Përfjashtim nga detyrimi

Përfjashtohen nga detyrimi për të marrë pjesë në operacionet e ndërhyrjes së emergjencave civile shtetasit:

- a) **Që për arsye shëndetësore nuk mund të kryejnë detyrat e operacioneve të ndërhyrjes;**
- b) **Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë me moshë deri në 10 vjeç;**
- c) **Prindër të vetëm me një fëmijë nën 10 vjeç.**

Neni 28

Të drejtat e shtetasve

Shtetasit që shërbejnë në përballimin e emergjencave civile, për një kohë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se sa periudha e situatës emergjente, gëzojnë të drejtat e parashikuara në nenin 24.

Neni 29

Personat fizikë dhe juridikë

- 1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët në veprimtarinë e tyre përdorin, prodhojnë, transportojnë ose magazinonë substanca të rrezikshme, detyrohen të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën e tyre të veprimtarisë.**
- 2. Personat fizikë dhe juridikë kanë për detyrë:**
 - a) Të hartojnë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojnë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë;**
 - b) Të njoftojnë personelin si dhe autoritetet e bashkisë ose të komunës për një rrezik imediat;**
 - c) Të organizojnë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre, dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjente në zonën e tyre të veprimtarisë;**
 - d) Të sigurojnë trajnimin për të punësuarit.**
- 3. Këshilli i Ministrave përcakton me akt nënligjor substancat që përbëjnë rrezikshmëri për krijimin e situatave emergjente.**

Neni 30

Detyrime të tjera

- 1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile, prefektët dhe kryetarët e bashkive e të komunave planifikojnë dhe zbatojnë detyra për ngritjen e kulturës qytetare në përballimin e emergjencave civile.**
- 2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton dhe miraton programet përkatëse për edukimin me elementet bazë të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile.**
- 3. Ky program fillon në arsimin 8-vjeçar dhe vazhdon deri në përfundimin e arsimit të lartë.**

KREU VI

FINANCIMI

Neni 31

Buxheti i shtetit

1. Buxheti i Shtetit është burimi parësor financiar për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.
2. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Pushtetit Vendor, si dhe të çdo ministrie parashikohet, zë më vete, buxheti për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Neni 32

Burime të tjera

Burime të tjera financimi mund të jenë:

- a) Buxheti i Shtetit i planifikuar për Këshillin e Ministrave;
- b) Të ardhurat e pushtetit vendor;
- c) Të ardhurat e krijuara nga shërbimi për të tretët të cilat kalojnë tërësisht në buxhetin e tyre;
- d) Donatorë të ndryshëm;
- e) Burime të tjera që i lejon ligji;

KREU VII

SANKSIONE

Neni 33

Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj

1. Mosrespektimi i detyrimeve që përcakton ky ligj, nga personat juridikë e fizikë, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 500 000 lekë nga strukturat operative të emergjencës civile, të cilat do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që përcakton ky ligj nga ana e individëve, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 25 000 lekë.

Neni 34
E drejta për ankim

Subjekti i gjobitur mund të ankohet dhe të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit që e dënon atë me gjobë, duke respektuar kërkesat Kodit të Procedurave Administrative përsa i përket të drejtës dhe procedurave të ankimit për aktin administrativ.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35
Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të tij, në pajtim me parimet e përgjithshme të neneve 5, 6, 9, 14 dhe 26 të këtij ligji.

Neni 36
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dekreti nr.3824, datë 1.12.1964 i Presidiumit të Kuvendit Popullor "Për mbrojtjen civile të Republikës", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 206 datë 26.03.1998

PËR

KRITERET PËR PJESËMARRJEN E SHTETIT NË PERBALLIMIN E
DËMEVE NË RASTE FATKEQËSISH

Me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- 1. Kur në zonat urbane dhe rurale ndodh dëmtim apo shkatërrim I banesave në pronësi të shtetasve, shteti mund të marrë pjesë me ndihmë financiare të pjesshme ose të plotë, për lehtësimin e dëmtimit të krijuar, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim. Shteti ndërhyr kur pasojat janë me rrezik për jetën e njerëzve dhe në këto raste merr masa për lehtësimin e gjendjes dhe mënjanimin e rrezikut për jetën e shtetasve.**
- 2. Këshilli I Ministrave merr pjesë me ndihmë financiare në rastet e dëmtimit të banesave, si pasojë e këtyre faktorëve:**
 - **Dëmtime nga termetet**
 - **Dëmtimet nga rrëshqitjet massive të trojeve**
 - **Dëmtime nga përmbytjet massive**
 - **Dëmtime nga zjarre ose nga shkaqe të tjera të forcave madhore**
- 3. Procedura e hartimit të dokumentacionit**

Bashkia ose komuna, ku ka raste të dëmtimit të ndërtesave të përmendurë në pikën 2 të këtij vendimi, krijon menjëherë një komision për hartimin e procesverbaleve të konstatimit të gjendjes. Këshilli I rrethit krijon një komision ekspertësh, të cilët, Brenda 10 ditëve nga dita e ngjarjes, bëjnë vlerësimet e mëposhtme:

- a) dëmet në anën ndërtimore
- b) dëmet ne orendi dhe pajisje nëse ka.

Këshilli I bashkisë apo komunës, pasi shqyrton procesverbalet për konstatimin e gjendjes dhe ato të komisionit të ekspertëve të Këshillit të rrethit, **merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare**. Ky vendim I paraqitet S.SH.P.L, pas konfirmimit të tij nga prefekti, së bashku me dokumentacionin vijues:

- **Procesverbalet e konstatimit të gjendjes**
- **Preventivat (nga ana ndërtimore, orendi e paisje)**
- **Akte ekspertize nga M.N.Z. për rastet e dëmtimit nga zjarri**
- **Raporti gjeologjik për rastet e rrëshqitjeve massive të trojeve**
- **Lista emërore e familjeve të dëmtuara, përbërja familjare në momentin e ngjarjes, e vërtetuar me çertifikata të gjendjes civile**
- **Kjo listë të firmoset nga nënpunësi I gjendjes civile dhe kryetari I bashkisë apo komunës.**
- **Vendimi i këshillit të rrethit për propozimet përkatëse, në rastet kur dëmi do të përballohet nga ky organ.**

4. Masat e ndihmës për rastet që do të trajtohen me këtë vendim

4.1 Për rastet e shkatërrimit të banesave, masa e ndihmës falas të jetë **40-50% e vlerës së banesës së re.**

Vlera e banesës së re do të llogaritet mbi bazën e kostos së ndërtimit të banesave nga E.K.B, për vitin përkatës kur do të llogaritet masa e ndihmës falas. Për rastet kur vlera e tregut të lirë të banesave është më e ulët se vlera e banesës së llogaritur mbi bazën e kostos së ndërtimit të banesave nga E.K.B, merret për bazë vlera e tregut të lirë të rrethit përkatës. **Në të gjitha rastet sipërfaqja e banesës së re do të jetë e njëjtë me atë të asaj ekzistuese.** Bëjne përjashtim rastet, kur sipërfaqja e banimit të banesës së vjetër është mbi normativat e strehimit; në këtë rast sipërfaqja e banesës së re do të llogaritet mbi bazën e përbërjes familjare.

Në rastet kur është e mundur të përdoren materialet e banesës ekzistuese, ndihma falas do të jepet në masën 40% të vlerës së dëmit.

4.2 Për rastet e dëmtimit të mesëm e të lehtë ndihma falas do të jetë në masën 50% të vlerës së dëmit.

4.3 Për rastet kur ka viktimë në njerëz jepet një ndihmë e menjëhershme falas jepet një ndihmë në masën **50.000 lekë për çdo viktimë.**

4.4 Në të gjitha rastet kur ka dëmtime **në pajisje dhe orendi**, pas vlerësimit real të dëmit **jepet ndihma falas deri në 20.000 lekë për frymë, por jo më shumë se 100.000 lekë për familje.** Për rastet kur vlerë e dëmit është më e vogël se masa e përfitimit falas për frymë, ndihma falas do të jetë e barabartë me vlerën e dëmit.

4.5 Në rastet kur zhvendosja e banesave kërkon zgjidhje të problemit me ndërtime masive, atëherë zbatohet ligji nr. 7848, dt. 25.07.1994 “Shpronësimet për interes publik”. Vlera e zhdëmtimit në lekë përballohet nga shteti.

4.6 Në rastet kur banesat janë bërë të pabanueshme, sipas vlerësimit nga komisioni i posaçëm, prefekti paraqet kërkesën në Këshillin e Ministrave (Rezervat e Shtetit apo Ministrinë e Mbrojtjes). Për pajisjen me çadra për sistemim të përkohshëm, që vihen në dispozicion sipas gjendjes.

5. Dëmtimet nga tërmetet

Për verifikimin e dëmëve të shkaktuar nga tërmetet ngrihen komisione ekspertësh në shkallë bashkie, komune apo rrethi të cilat, brenda 10 ditëve nga dita e rënies së tërmetit hartojnë procesverbalet përkatëse të shoqëruara me preventiva. Dokumëntacioni i plotë i përgatitur nga komisionet, pas konfirmimit në prefekturë, i dërgohet Sekretariatit Shtetëror për pushtetin lokal, i cili në varësi nga shtrirja gjeografike dhe përmasat e dëmit, kërkon pranë Këshillit të Ministrave ngritjen e komisionit të posaçëm qeveritar, në përbërje të të cilit të jenë specialistë të fushave përkatëse nga ministritë dhe institucionet qendrore për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes në vend.

Për dëmtime të rënda, në raste të veçanta, me arsye të motivuar, Këshilli i Ministrave ndihmon në përballimin e dëmit, në bazë të propozimit të bërë nga komisioni posaçëm qeveritar.

6. Dëmtimet nga rrëshqitja masive e truallit

Në rastet e dëmtimeve nga rrëshqitjet masive të truallit, të kryhet studimi gjeologjik nga institucionet e specializuara të autorizuara për këtë qëllim nga Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Me anë të këtij studimi të përcaktohet paqendrueshmëria e truallit, shtrirja që zë rrëshqitja, zhvendosjet e domosdoshme të banesave, sipas shkallës së rrezikshmërisë:

- a) Banesa me rrezikshmëri të lartë, ku përfshihen banesat brenda trupit rrëshqitës**
- b) Banesa me rrezikshmëri të ulët, ku përfshihen banesat jashtë trupit rrëshqitës**

Për secilin rast ndërhyrjet e shtetit të jenë të diferencuara.

Për pikën “a” masa e ndihmës të jetë sipas pikës 4.1.

Për pikën “b” masa e ndihmës të jetë sipas pikës 4.2.

Përcaktimi i zhvendosjes së banesave bëhet brenda zonës së zhvillimit me plan rregullues të miratuar nga K.RR.T-ja e rrethit.

7. Dëmtimet nga përmbytjet masive, zjarret dhe shpërthimet me lëndë plasëse

- Procedura që ndiqet për këto raste do të jetë sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Masa e ndihmës falas të jetë sipas pikës 4 të këtij vendimi.

Në rastet kur shkak i djeties ose shpërthimit nuk përcaktohet menjëherë, vetë pronari i ndërtesës duhet të paraqesë kërkesë për ekspertim në organet kompetente. Raporti i ekspertëve duhet t'i bashkëngjitet dokumenteve të tjera.

8. Burimet financiare të përballimit të dëmeve

8.1 Organi i pushtetit lokal përkatës (bashkia ose komuna) ka të drejtë të përdorë për qëllimet që parashtron ky vendim, fondin rezervë të miratuar, të ardhurat si dhe sponsorizimet dhe donacionet që mund t'i vihen në dispozicion nga donatorë të ndryshëm. Përdorimi i këtyre fondeve bëhet me vendim të Këshillit të Bashkisë apo komunës.

8.2 Në të gjitha rastet fondet që jep organi i pushtetit lokal ose Këshilli i Ministrave sipas këtij vendimi, administrohen nga organi i pushtetit lokal (bashkia ose komuna) përkatës. Ky organ ka detyrën e kontrollit të përdorimit të fondit vetëm për qëllimin e dhënies së tij. Për këtë mund të aplikojë dhënien me këste të fondit të akorduar duke kërkuar në vazhdimësi nga përfituesit dokumente që vërtetojnë përdorimin e këtij fondi për qëllimin e dhënies së tij.

8.3 Titullarët e organeve të pushtetit lokal, komisionet ose institucionet e tjera mbajnë përgjegjësi për zbatimin e procedurave të përmendura në këtë vendim.

8.4 Nëse organet e kontrollit në komunë, bashki, rreth, prefekturë, Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal apo organet e tjera konstatojnë abuzime në vlerësimin e dëmeve nga komisionet, shkaktarët vihen përpara përgjegjësisë materiale dhe çështja dërgohet për ndjekje penale.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministrie e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal, si dhe komunitat, bashkitë, rrethet e prefekturat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Fatos Nano



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 654, datë 18.12.2002

PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PËRDORIM TË PËRKOHSHËM NGA
ORGANET SHTETËRORE, NË SITUATA EMERGJENTE, TË ÇDO MJETI
PRIVAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 2, 31, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, "Për emergjencat civile", dhe të nenit 37, të ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001, "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat, si më poshtë vijon :
 - a) Strukturat operative të emergjencave civile, në situata emergjente, kanë të drejtë të marrin në përdorim të përkohshëm çdo mjet privat, kundrejt pagesës, sipas tarifave të përcaktuara në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) Për mjetet e tjera, që nuk janë përmendur në këtë shtojcë, llogaritjet të bëhen sipas fuqisë dhe tonazhit të tyre.
Llogaritja bëhet duke shumëzuar vlerën në tabelë me koeficientin $k=1.2$, kur fuqia / tonazhi është më e/i madh dhe e kundërta. Për mjetet e transportit e materialeve të përdoret tabela për ton/km, kurse për mjetet stacionare fuqia në kw.
 - c) Kur strukturat operative të emergjencave civile, për mjetet që marrin në dispozicion, përballojnë karburantin nga rezervat e veta, atëherë tarifa llogaritet mbi bazën e orëve të punës për manovratorin, plus konsumin e pjesëve të ndërrimit, (në rast konsumi) plus 10 për qind, si më poshtë vijon :
 $T=(m+0.2\% m) + 10\%$; ku T- tarifa ; m- pagesa për një orë pune për manovratorin. Koeficienti $m=120$ deri 160 lekë, në varësi të tonazhit/fuqisë së mjetit. Kufiri minimal për tonazhin/fuqinë më të ulët dhe e kundërta.
 - d) Kur merren mjete në dispozicion për transportin e udhëtarve, si : autobusë, mikrobusë, etj, tarifatat janë të njëjta me ato të udhëzimit të përbashkët nr. 373/1, datë 24.3.1998, të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe nr.99/3, datë 24.3.1998, të Ministrisë së Financave.
2. Mjetet merren në përdorim të përkohshëm, sipas aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet drejtuesve të operacionit ose përfaqësuesve të autorizuar prej tyre, për përbashkimin e situatave emergjente, për aq kohë sa është e domosdoshme, por jo më vonë se koha e përfundimit të emergjencës.

3. Shpenzimet, që rezultojnë nga përdorimi i përkohshëm i mjeteve private, në raste të situatave emergjente, të përballohen nga burimet financiare të institucionit, të siguruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

F A T O S N A N O

MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT

BEN BLUSHI

SHTOJCA

TARIFAT PER MJETET TRANSPORTUESE VETEEVIZESE

Tabela 1

Nr.	Largesia e transportit	km	Ton/km	ne Lekë
1.	Transporti deri në	0.2	-:-	40
2.	Transporti deri në	0.5	-:-	30
3.	Transporti deri në	1	-:-	25
4.	Transporti deri në	2	-:-	22
5.	Transporti deri në	3	-:-	20
6.	Transporti deri në	4	-:-	18
7.	Transporti deri në	5	-:-	17
8.	Transporti deri në	6	-:-	16
9.	Transporti deri në	7	-:-	15
10.	Transporti deri në	8	-:-	14.5
11.	Transporti deri në	9	-:-	14
12.	Transporti deri në	10	-:-	12.8
13.	Transporti mbi	10	-:-	12
14.	Autoambulance	1.5	-:-	20
15.	Sheverlet	1.5	-:-	15

TARIFA PËR MJETET NGRITËSE

Tabela 2

Nr.	Emertimi i Mjetit Ngritës	Aftesia ngritese ne ton.	Lek/ore
1	Autovinç	1.5	890
2	Autovinç	5	1500
3	Autovinç	8	1750
4	Autovinç	10	1900
5	Autovinç	16	2100
6	Autovinç	20	3000
7	Autovinç	mbi 20	3500

MJETE GERMIMI**Tabela 3**

Nr.	Emertimi i mjetit	Njesia matese	Kapaciteti	1 ore / pune	Ne leke
1.	Fadrome “ UNK 320”	-		- :-	4500
2.	Buldozer DT-54	-		- :-	1408
3.	Buldozer DT-75	-		- :-	1502
4.	Buldozer S 80 - 100	-		- :-	2203
5.	Buldozer S-150	-		- :-	2890
6.	Buldozer S- 350 HP	-		- :-	3426
7.	Eskavator	m3	0.15	- :-	1220
8.	Eskavator	m3	0.25	- :-	1391
9.	Eskavator	m3	0.35	- :-	1409
10.	Eskavator Varinski	m3	0.4	- :-	1511
11.	Eskavator Varinski	m3	0.5	- :-	2225
12.	Eskavator Varinski	m3	1-1.25	- :-	2673
13.	Eskavator Varinski	m3	2	- :-	3567
14.	Fadrome Volvo	-		- :-	3607
15.	Motorpompa “ Gaz 51”	L/min		- :-	1500
16.	Motorkompresor	m3/sek		- :-	2000
17.	Motor gjenerator	Kw	40	- :-	2000
18.	Motor gjenerator	Kw	68	- :-	2500
19.	Zjarrfikese	ton	9	- :-	3500



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 655, date 18. 12. 2002

PËR

NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SË SISTEMIT
KOMBËTAR TË PLANIFIKIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË
EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5, pika 1, 11, pika 1, 13 dhe 35, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile", me propozimin e ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e sektorit të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile në strukturat e ministrive të mëposhtme:
 - Ministrinë e Mbrojtjes;
 - Ministrinë e Rendit Publik;
 - Ministrinë e Shëndetësisë;
 - Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit;
 - Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit;
 - Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit;
 - Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës;
 - Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës.
2. Vendosjen e specialistëve për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në:
 - Ministrinë e Mjedisit;
 - Ministrinë e Kulturës,
 - Rinisë dhe Sporteve;
 - Ministrinë e Financave;
 - Ministrinë e Drejtësisë;
 - Ministrinë e Ekonomisë;
 - Ministrinë e Punëve të Jashtme;
 - Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.
3. Pranë ministrive të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të funksionojë Komisioni i Planifikimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe përgjegjësitë përcaktohen nga ministri përkatës, në përputhje me nenin 11, pikat 1 dhe 2, të ligjit

nr.8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile". Detyrat e këtij komisioni përcaktohen në shtojcën "Rekomandime", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në strukturën e Ministrinë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, në Departamentin e Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile funksionon Qendra Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile, me strukturë të përhershme, në kohë normale, dhe me strukturë të përkohshme, në raste emergjencash civile.
 - a) Struktura e përkohshme përbëhet nga ajo e përhershme dhe, sipas llojit të emergjencës, thirren/njftohen specialistë të ministrive e institucioneve të tjera, përfagësues të Kryqit të Kuq Shqiptar dhe, në rast nevojë, edhe specialistë ndërkombëtarë.
 - b) Ministrinë dhe institucionet përkatëse përzgjedhin dhe caktojnë 1-2 specialistë të fushës, që kanë të gjitha të dhënat e nevojshme për burimet e institucionit të tyre, si dhe autoritetin e domosdoshëm për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje.
5. Në përbërje të strukturës së administratës së prefektit ngrihet zyra e Planifikimit dhe e Përballimit të Emergjencave Civile, në nivel qarku.
 - a) Nën drejtimin e prefektit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Planifikimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile, në nivel qarku. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni përcaktohen me udhëzim të ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.
 - b) Në përbërje të organikës së zyrës së nënprefektit caktohet dhe inspektori për emergjencat civile.
6. Për organet vendore:
 - a) Në bashkinë e Tiranës ngrihet zyra e planifikimit dhe e përballimit të emergjencave civile.

Struktura e kësaj zyre të jetë sipas lidhjes 1/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- b) Në struktura të administratës së kryetarit të qarkut, të bashkisë dhe të komunës, caktohet një specialist me funksion të dytë, për mbulimin e problemeve të emergjencave civile.
7. Rekrutimi dhe trajtimi i personelit të strukturave të emergjencave civile.
 - a) Personeli, që do të rekrutohet në strukturat e mësipërme, të përzgjidhet nga kontigjenti i ish-ushtarakëve, sipas specifikave të institucioneve përkatëse.
 - b) Kriteret për përzgjedhjen e këtij personeli përcaktohen me udhëzim të ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.
 - c) Emërimi i personelit të emergjencave civile në administratën e prefektit bëhet nga prefekti, sipas procedurave të parashikuara nga ligjet në fuqi.
 - d) Personeli i strukturave të emergjencave civile ka të njëjtin status me atë të personelit të institucionit që i përket.
 - e) Numri i punonjësve, fondi i pagave dhe shpenzimet e kësaj strukture të mbulojnë nga buxheti vjetor i institucioneve përkatëse.
8. Vendkomandat e kohës së veçantë, të cilat kanë qenë në administrim të ish-këshillave të rretheve, kalojnë në administrimin e prefektit, kurse ato të komunitetit administrohen e mirëmbahen nga bashkitë dhe komunat.
9. Vendimi nr.292, datë 27.3.1995, i Këshilli të Ministrave, "Për kalimin e shërbimit të MCR-së në Ministrinë e Brendshme", dhe çdo vendim e strukturë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

REKOMANDIME

A. Per Ministrite:

Bazuar ne nenin 11, piken 1 dhe 2, te ligjit nr. 8756, dt.26.03.2001, "Per emergjencat civile", eshte pergjegjesi e çdo ministri per te ngritur dhe percaktuar detyrat dhe menyren e funksionimit te Komisionit per planifikimin dhe perballimin e emergjencave civile ne linjen e ministrise qe drejton, por me poshte jepen disa rekomandime.

Komisioni drejtohet nga titullari, ose nga zevendesesi i tij dhe mund te kete ne perberje antare te perhershem ose te ndryshueshem. Ai mund te mblidhet sa here qe e shikon te arsyeshme titullari.

Ne kete komision marrin pjese si antare, drejtore drejtorish, specialiste te fushes perkatese, si dhe drejtore ose kryeinxhinier te ndermarrjeve vartese te ministrise.

Ky Komision, ka keto detyra kryesore:

- Pergatitjen e strategjise, projekteve e programemeve per parandalimin, planifikimin dhe perballimin e emergjencave civile
- Miratimin e Planit per perballimin e emergjencave civile ne linjen e ministrise, si pjese e planit kombetar te perballimit te emergjencave civile.
- Ndjekjen e realizimit te detyrave ne drejtim te masave parandaluese.
- Pergatitjen e projektbuxhetin, si ze me vehte per emergjencat civile,
- Koordinimin mes drejtorive te dikaserit, drejtorive rajonale, drejtorive e ndermarrjeve vartese, te cilat kane lidhje me emergjencat civile.

Disa nga detyrat e sektorit /specialistit te planifikimit dhe perballimit te emergjencave civile

Sektori i emergjencave ose specialisti (koordinator) sherben si sekretarjat per pergatitjen e mbledhjeve dhe te gjithe puneve administrative qe nevoiten per funksionimin normal te Komisionit.

Gjithashtu ky sektor do te marre dhe perpunoje te dhenat ne lidhje me resurset qe ka vete ministria. bazen e te dhenave materialo teknike, qe disponon ministria ne linjen e saj, etj.

Sektori do te jete pika e kontaktit e ministrise me Drejtorine e Pergjithshme te Emergjencave Civile ne Ministrine e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit Sektori i Planifikimit per Perballimin e emergjencave civile ne ministri do te pergatise programe, plane e skenare situatash emergjente, per trainimin e personelit te Ministrise, forcave operacionale dhe ndermarrjeve te varesise si dhe biznesit privat natyra e aktivitetit te te cileve lidhet me matyren e Ministrise.

Ky sektor pervec detyrave te mesiperme ka dhe keto detyra:

- Te percaktoje rregullat e perdorimit te burimeve materiale e financiare ne rastet e emergjencave civile.
- Te bashkerendoje organizimin dhe pajisjen e forcave te nderhyrjes ne rastet e emergjencave civile.

- Te organizoje, zbatoje dhe monitoroje sistemin e te dhenave ne nivel ministrie per situatat e emergjencave civile.
- Te bashkpunoje me Drejtorine e Pergjithshme te Emergjencave Civile, per vleresimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera, dhe riaftesimin e tyre, ne perputhje me aktet nenligjore perkatese.
- Te kontrolloje zbatimin e masave mbrojtese dhe parandaluese ne rastet e emergjencave civile.
- Te hartoje udhezime per institucionet, entet, drejtorite rajonale, ndermarrjet vartese te tyre, per fushen e emergjencave civile.

B. Per Qarkun, Bashkine dhe Komunen:

Ne zbatim te ligjit nr 8756 dt 26.03.2001 Neni 15, 16 dhe 17 perberja, rregullat dhe menytrat e funksionimit te Komisionit te Qarkut dhe Komisionit vendor percaktohen me udhezim te Ministrit te Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Rekrutimi i personelit:

Specialistet e ketij sektori do te jene ish ushtarake te cilet do ti nenshtrohen nje testimi profesional te pergatitur nga Drejtoria e Pergjithshme e Emergjencave Civile, ne Ministrine e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Per Ministrite si ajo e shendetesise kandidatet do te jene me edukim baze sipas specialitetit te Ministrise perkatese.

Keto punonjes gezojne status te njejte me ate qe kane institucionet perkatese.

Nga paragrafet i mesiperm perjashtohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik, te cilet kane status te veçante dhe mund te plotesojne organiken e sektorit me efektivat e tyre.

10. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, te gjitha ministrite dhe institucionet e tjera, te percaktuara ne kete vendim, per zbatimin e tij.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare"

KRYEMINISTRI

FATOS NANO

MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT

BEN BLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 663 ,datë 18.12.2002

PËR
PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT
TEKNIK KËSHILLIMOR TË SPECIALISTËVE PËR EMERGJENCAT
CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, Për emergjencat civile” me propozimin e ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni Teknik Këshillimor të ketë në përbërje përfaqësues si më poshtë vijon:

A. Nga Këshilli i Ministrave 1

B. Nga ministrinë:

-Ministria e Mbrojtjes	2
-Ministria e Shëndetësisë	2
-Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	2
-Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	2
-Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit	2
-Ministria e Arsimit dhe e Shkences	1
-Ministria e Industrisë dhe e Energjitikës	1
-Ministria e Mjedisit	1
-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1
-Ministria e Financave	1
-Ministria e Drejtësisë	1
-Ministria e Ekonomisë	1
-Ministria e Punëve të Jashtme	1
-Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale	1
-Ministria e Rendit Publik	1

C. Nga institucione shkencore dhe monitoruese

-Akademia e Shkencave	1
-Sekretariati Shtetëror i Digave të Larta	1
-Universiteti Politeknik i Tiranës	3
-Instituti i Sizmiologjisë	1
-Instituti i Hidrometeorologjisë	1
-Instituti i Fizikës Bërthamore	1
-Instituti i Shëndetit Publik	1
-Instituti i Higjenës dhe i Epidiomologjisë	1
-Instituti i Kërkimeve Veterinare	1
-Instituti i Kërkimeve Ushqimore	1
-Instituti i Pyjeve dhe i Kullotave	1
-Instituti i Studimeve për Transportin	1
-Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndertimit	1
-Qendra e Studimeve Gjeografike	1
-Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1
-KESH	1

Ç. Nga Kryqi i Kuq, OJF-të dhe agjencitë e OKB-së

-Kryqi i Kuq Shqiptar	1
-Kordinatori rezident i OKB-së në Shqipëri	1
-Organizatrat jofitimprurëse	1

2. Mënyra e funksionimit të Komisionit Teknik Këshillimor.

- a. Komisioni Teknik Këshillimor thërritet dhe drejtohet nga drejtori i Departamentit të Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, sa herë që ai e gjykon të nevojshme, por jo më pak se një herë në tre muaj.
- b. Anëtarët e komisionit, përveç takimeve të rregullta, duhet të jenë të gatshëm për të marrë pjesë dhe të angazhohen në detyra të veçanta individuale dhe në grupe, që kërkohen nga komisioni teknik.
- c. Përfaqësuesit e përmendur në shkronjë "A" janë anëtarë të përhershëm të komisionit, përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "B", përjashtuar atë të Akademisë së Shkencave, ftohen në varësi të nevojave, ndërsa përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "C" janë vëzhgues të përhershëm.
- d. Përfaqësuesit e përmendur në shkronjën "A", niveli përfaqësimit të jetë nënkryetar i komisionit të emergjencave civile, në nivel drejtor drejtorie ose të barazuar me ta, ndërsa për përfaqësuesit e përmendur në shkronjat "B" dhe "C" drejtues institucioni, agjencie apo shoqate.
- e. Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, përgjigjet për përgatitjen e materialeve dhe për njoftimin për mbledhjen e radhës së komisionit, duke ia dërguar, çdo anëtar, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
- f. Pranë Komitetit Teknik Këshillimor funksionon sekretaria teknike, me punonjës të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.
- g. Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, për probleme të veçanta të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, i propozon ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, ngritjen e grupeve të përkohshëm të punës, me objekt dhe afate të përcaktuara, me punonjës të brëndshëm ose nga jashtë ministrisë.ë. Ministri, me propozimin e drejtorit të departamentit, në bazë të akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, përcakton mënyrën dhe masën e shpërblimit të anëtarve të komisionit dhe të sekretarisë për punën e kryer shtesë, jashtë detyrave të tyre.

3. Komisioni Teknik Këshillimor ka përgjegjësi:

- a. Të përgatisë strategjinë, politikat dhe programet në fushën e mbrojtjes civile, shëndetin publik, pasurinë, vlerave kulturore dhe mjedisit rrethues nga ndikimet e emergjencave civile;
 - b. Të përgatisë dhe të zhvillojë programe edukimi për strukturat e emergjencave dhe publikun e gjërë në fushën e mbrojtjes civile;
 - c. të zhvillojë, të parashikojë dhe përditësojë materialin e rreziqeve, si dhe të vlerësojë mundësitë për përballimin e tyre.
 - d. Të përpunojë planet për përballimin e emergjencave civile, të përgatitura nga institucionet shtetërore dhe jo shtetërore, dhe t'i përfshijë ato në Planin Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile.
 - e. Të mbikëqyrë dhe të ndihmojë në ngritjen e sistemit kombëtar të Emergjencave Civile, si dhe në vënien në efikasitet të plotë të tyre.
 - f. Të përgatisë modele dhe skenare për stërvitjen e trupave operationale të shërbimit të emergjencave civile dhe për nivele të ndryshme të qeverisjes, vendore e qendrore.
 - g. Të ofrojë rrugët e zgjidhjes për masat parandaluese dhe të rehabilitimit për lloje të ndryshme fatkeqësish natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, para, gjatë dhe pas situatave emergjente.
 - h. Të ndërmarrë nisma dhe studime për pakësimin e dëmit dhe të efekteve të tjera negative, që mund të vinë si rezultat i emergjencave civile.
 - i. Të përgatisë dhe të zhvillojë projektin e integruar të komunikimit me sinjal 112, në të gjithë sistemin e emergjencave civile.
4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit
 5. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO

MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT

BEN BLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 664 ,datë 18.02.2002

PËR

KRITERET DHE PROCEDURAT E SHPALLJES SË GJENDJES SË
EMERGJENCES CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 35, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile", me propozimin e ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Gjendja e emergjencës civile mund të shpallet në një pjesë të territorit ose në të gjithë territorin e vendit.
2. Gjendja e emergjences civile shpallet kur me mundësitë dhe burimet që zotërohen në kushte normale, nuk mund të përballohen pasojat e shkaktuara nga fatkeqësia.
3. Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile janë të nevojshme të dhënat e mëposhtme:
 - a. Shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar;
 - b. Ndikimet e këtyrë dëmeve në prishjen e ekuilibrave të jetës normale të komunitetit;
 - c. Të dhënat shkencore nga institutet përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.
4. Në rast tërmeti, mund të shpallet gjendja e emergjencës civile, për shkak të fatkeqësisë natyrore, kur sigurohen të dhënat sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij vendimi.

Procedurat që ndiqen për shpalljen e gjëndjes së emergjencës civile në rast tërmeti janë:

- a. Instituti sizmiologjik, brenda 2 orëve jep në Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, të dhënat e para, të regjistruara dhe, në mënyrë periodike, plotëson këto të dhëna deri në shuarjen përfundimtare të goditjeve sizmike.
- b. Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile, paraqet raportin njohës për ministrin e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, pas marrjes së të dhënave, për dëmet e shkaktuara e vlerësimin paraprak të gjëndjes nga Instituti Sizmiologjik, komuna a bashkia dhe qarku.
- c. Këshilli i Ministrave, pas mbledhjes së të dhënave të nevojshme, vendos shpalljen e gjëndjes së emergjencës për atë pjesë territori.

5. Në rastet e përmbytyjeve mund të shpallet gjendja e emergjencës civile kur:
 - a. Niveli i ujërave arrin pika kritike, në disa zona të matshme;
 - b. Një ose më shumë lumenj, që përshkojnë vendin, kanë dalë jashtë shtratit, në përmasa të rrezikshme;
 - c. Prita rezervuaresh dhe diga liqenesh janë dëmtuar rëndë;
 - d. Jeta e popullsisë civile, e gjësë së gjallë dhe prona janë rrezikuar seriozisht.
6. Procedura për shpalljen e gjëndjes së emergjencës civile në rastin e përmbytyjes të jetë e njëjtë me procedurën e përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi. Të dhënat e regjistruara do të jepen nga Instituti Hidrometeorologjik dhe /ose nga organet e qeverisjes vendore, rast pas rasti dhe periodikisht, çdo 4 orë nga fillimi i reshjeve.
7. Këshilli i Ministrave pas mbledhjes së të dhënave të nevojshme, shpall gjëndjen e emergjencës civile në një zonë të caktuar ose në të gjithë vendin, kur shtrirja e kësaj emergjence i kalon mundësitë për t'u përballuar nga qarku dhe kërkohet të vihen në punë burimet e qarqeve fqinjë ose të niveleve qendrore.
8. Kriteret kryesore për shpalljen e gjëndjes së emergjencës civile për fatkeqësitë, si rezultat i veprimit të njerëzve, epidemive, aksidenteve industriale dhe rrezatimeve radioaktive, etj, përcaktohen rast pas rasti, sipas efekteve që do të kenë në zonën e goditur dhe sipas mundësive që ekzistojnë për përballimin e tyre, në nivelet e qeverisjes vendore.
9. Propozimi për shpalljen e emergjencës civile në këto raste ndërmerret nga ministritë e linjës sipas veçorive të fenomeneve që shfaqen, si dhe të kompetencave e funksioneve që mbulojnë, në bashkëpunim me institutet përkatëse dhe organet e qeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia.
10. Ngarkohen të gjitha ministritë, institutet kërkimore e shkencore përkatëse, entet publike, që kanë lidhje me emergjencat, dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO

MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT

BEN BLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 531, datë 01.08.2003

PËR
ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E
SHËRBIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, me propozimin e ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shërbimi i emergjencave civile, në nivel qendror dhe vendor, funksionon përmes 3 strukturave bazë operative:
 - a. Strukturat monitoruese / njoftuese;
 - b. Strukturat vepruese, aktive;
 - c. Strukturat vepruese, mbështetëse.
2. Strukturat **monitoruese / njoftuese** përbëhen nga ministrinë, institucionet dhe institucionet e varësisë, Instituti Hidrometeorologjik, Instituti Sizmik, Instituti i Fizikës Bërthamore, Instituti i Kërkimeve Veterinare, Instituti i Kërkimeve Ushqimore, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, Instituti i Shëndetit Publik, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve.
3. Strukturat **monitoruese / njoftuese**, së bashku me zyrat dhe inspektorët e emergjencave civile në administratën e prefektit, të ngarkuarit me problemet e emergjencave civile në bashki dhe komunë, japin të dhëna të vazhdueshme pranë Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, për parashikimin dhe ndodhjen e fenomeneve, të ngjarjeve dhe të aksidenteve, që dëmtojnë apo rrezikojnë jetën normale të shtetasve në Republikën e Shqipërisë, si dhe vendet e rajonit.
4. Strukturat **vepruese, aktive** përbëhen nga baza e mbrojtjes civile, Shërbimi i Kërkim - Shpëtimit (SAR), si dhe njesitë e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa kryejnë detyra për përballimin e emergjencave civile, strukturat e Policisë së Shtetit, repartet e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në qarqe, si dhe stacionet zjarrfikëse, të krijuara me ligj, pranë objekteve me rëndësi ekonomike, shtetërore dhe joshetërore, shërbimi i ambulancës, shërbimi i urgjencës mjekësore, Inspektoriat i Kontrollit Radiologjik dhe Inspektoriat i Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor, reparti i inspektim-shpëtimit të minierave, reparti i likuidimit të avarive të KESH, sha-së, Policia Elektrike dhe reparti avaro-shpëtues dhe i kërkim-përpunimit të naftës.
5. Strukturat **vepruese, aktive** angazhohen menjëherë për përballimin e çdo shtetërore të krijuar nga faktorë të ndryshëm, që kërcënojnë jetën, pronën dhe veprimtarinë normale të shtetasve, sipas

planeve të gatishmërisë dhe të veprimit për situata të emergjencave civile, të hartuara dhe të miratuara më parë.

6. Strukturat **vepruese, mbështetëse** janë: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, vrojtuesit, Policia Pyjore dhe ndërmarrjet rajonale të ujrave, ndërmarrjet rajonale të ujësjellës-kanalizimeve, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve urbane dhe strukturat e Policisë së Ndërtimit, ndërmarrjet rajonale të mirëmbajtjes së rrugeve dhe grupet e eliminimit të avarive, të Telecom-it, strukturat e Policisë Tatimore, dhe të Doganave, organizmat ndërkombëtare dhe/ose jofitimprurëse, që kanë lidhje me emergjencat civile, brenda ose jashtë vendit, grupet dhe individë vullnetarë, strukturat ndërkombëtare, të specializuara për ndihmë humanitare, si Kryqi i Kuq Shqiptar dhe OJF-të që veprojnë në vend.
7. Strukturat **vepruese, mbështetëse**, planifikohen për ndërhyrje në situata emergjente dhe angazhohen në situatat e krijuara, në mbështetje të strukturave vepruese, aktive.
8. Me kërkesën e prefektit, në rastet kur shtrirja e një emergjence civile rritet në mënyrë të menjëhershme, pas njoftimit të drejtuesve të organeve qendrore, që kanë në varësi strukturat përkatëse, për përballimin e situatave mund të angazhohen strukturat vepruese, mbështetëse që veprojnë në territorin e qarkut, por që janë varësi të drejtëpërdrejtë të organeve qendrore.
9. Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile shërben si pikë kontakti, në nivel kombëtar, për të gjitha problemet që kanë lidhje me emergjencat civile, si në kohë të qetë, edhe në kohë emergjence.
10. Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, në veçanti, mban lidhje të vazhdueshme me Qendrën e Bashkuar Operacionale të Ministrisë së Mbrojtjes, Qendrën e Informacionit, të Ministrisë së Rendit Publik, si dhe me çdo pikë kontakti të organeve, qendrore vendore, dhe me institutet dhe agjencitë që lidhen me emergjencat civile. Këto struktura kanë detyrime të ndërsjella për dhënien dhe marrjen e informacionit.
11. Ekipet dhe ndihmat, që vijnë nga shtete të tjera dhe strukturat ndërkombëtare të emergjencave civile, veprojnë në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të ndihmës humanitare sipas standarteve dhe procedurave ndërkombëtare, konventave për dhënie ndihme në rastet e emergjencave civile, marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh dhe në përputhje me apelet e kërkesat që u bëhen nga strukturat përgjegjëse shtetërore.
12. Komiteti Ndërmarrës i Emergjencave Civile, ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe drejtuesi qendror i operacionit, kur emergjencat civile kanë rritje të menjëhershme dhe kërcënuese, i kërkojnë Kryeministrit, ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Rendit Publik, përdorimin e Forcave të Armatosura, të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe Speciale, në operacionet për përballimin e emergjencave civile dhe riaftësimin e zonave të dëmtuara.
13. Baza e mbrojtjes civile, njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe repartet speciale të Ministrisë së Rendit Publik, në operacionet e shpëtimit dhe të riaftësimit drejtohen nga komandantët e tyre, sipas detyrave që i jepen nga drejtuesi i operacionit.
14. Kur shtrirja ose ndikimet e një emergjence civile rriten në mënyrë të menjëhershme dhe bëhet e paperballueshme nga kapacitetet që ka qarku, prefekti i drejtohet ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, i cili i kërkon Kryeministrit, ministrit të Mbrojtjes ose ministrit të Rendit Publik angazhmin e njësisë të Forcave të Armatosura dhe të Forcave Speciale të Ministrisë së Rendit Publik.
15. Në rast situatë emergjente, me kërkesë të kryetarit të bashkisë ose të komunes, prefekti cakton, pranë komisionit vendor për emergjencat civile të bashkisë ose komunës, një pjesë ose të gjithë stafin e zyrës së emergjencave të administratës së tij.
16. Në rast të një fatkeqësie të menjëhershme, katastrofike, kryetari i bashkisë ose i komunës u drejtohet, drejtëpërdrejtë, për ndihmë të gjithë drejtuesve të strukturave të sistemit të emergjencave civile, që veprojnë në territorin e tij ose të atyre fqinjë, njofton menjëherë

prefektin dhe qendrën kombëtare operacionale, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

17. Në varësi të tipit dhe të permasave të fatkeqësisë, qendra kombëtare operacionale e emergjencave civile njofton strukturat e shërbimit të emergjencave civile të çdo niveli, të cilat, pas këtij njoftimi, vihen në gjendje gatishmërie.
18. Të gjitha efektivat e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, për kohën që kryejnë detyra në përballimin e këtyre emergjencave, krahas stemës së institucionit përkatës mbajnë dhe stemën e Shërbimit të Emergjencave Civile të Republikës së Shqipërisë, e cila miratohet me këtë vendim dhe përdoret në uniformat e strukturave të Shërbimit të Emergjencave Civile dhe në shkresat zyrtare.
19. Stema e Shërbimit të Emergjencave Civile është sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
20. 26 marsi, dita e miratimit të ligjit “Për emergjencat civile”, njihet si dita e shërbimit të emergjencave civile.
21. Strukturat e drejtimit operacionel të emergjencave civile, në nivel qendror dhe vendor, janë pjesë e strukturave kombëtare të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile.
22. Në rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile, drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, deri në caktimin e drejtuesit të operacionit, e merr komandanti i stacionit zjarrfikës më të afërt. Në të gjitha rastet, veprimet operacionale kryhen në zbatim të manualit “Mbrotjtja civile”, i cili miratohet nga ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit.
23. Kur shpallet gjendja e emergjencave civile, për drejtimin e strukturave të shërbimit të emergjencave civile, caktohen drejtuesit e operacioneve në nivelet e mëposhtme:
 - a. Drejtuesi qendror i operacionit, i cili emërohet nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile.
 - b. Drejtuesi i operacioneve në nivel qarku, i cili emërohet nga prefekti.
 - c. Drejtuesi i operacioneve në nivel bashkie dhe komune, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë / komunës.
 - d. Drejtuesit e forcave vepruese të shërbimit të emergjencave civile, në nivel qendror dhe vendor, si dhe qendrat operacionale të tyre.
24. Drejtuesi Qendror i Operacionit, kryen këto detyra:
 - a. Vepron sipas udhëzimeve që merr nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile dhe raporton përpara këtij komiteti, rast pas rasti ose sa herë që e gjykon të nevojshme ky komitet.
 - b. Menaxhon situatën dhe strukturat e shërbimit operacionel të emergjencave civile në nivel qendror, në zbatim të planit kombëtar për përballimin e emergjencave civile.
 - c. Vendos lidhje të drejtpërdrejta me Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, edhe i kërkon atij raporte; periodike e permbledhëse, për situatën.
 - d. Kërkon nga drejtuesit e operacioneve dhe të strukturave të shërbimit të emergjencave civile, të niveleve më të ulta, zbatimin e detyrave për përballimin e emergjencave civile.
 - e. Bashkëpunon me drejtuesit e operacioneve dhe strukturat e shërbimit të emergjencave civile në bashki dhe komuna.
25. Drejtuesi i Operacionit në nivel qarku kryen keto detyra:
 - a. Menaxhon situatën, nëpërmjet drejtimit të strukturave operacionale të shërbimit të emergjencave civile, në zbatim të planeve të hartuara më parë për përballimin e emergjencave civile në nivel qarku.

- b. Vepron sipas udhëzimeve që merr nga komisioni i bashkërendimit të veprimtarive për emergjencat civile në qark dhe raporton përpara këtij komisioni, rast pas rasti ose sa herë që e gjykon të nevojshme ky komision.
- c. Vendosi lidhje të drejtpërdrejta me drejtuesin qendror të emergjencave civile pranë Komitetit Nderministror të Emergjencave Civile, me drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, dhe dërgon raporte, periodike e përmbledhëse, për situatën.
- d. Bashkepunon me drejtuesit operacionalë dhe strukturat e shërbimit të emergjencave civile në bashki dhe komuna.
- e. Bashkëpunon me grupe të shërbimit vullnetar të emergjencave civile dhe me organizma e institucione të huaja, të specializuara në perballimin e emergjencave civile, që ofrojnë ndihme në territorin.

26. Drejtuesi i operacionit në bashki /komunë kryen këto detyra:

- a. Zbaton udhëzimet e kryetarit të bashkisë/komunës, mban lidhje të vazhdueshme me zyrën e emergjencave civile të administratës së prefektit dhe me qendrën kombëtare operacionale të emergjencave civile, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.
- b. Raporton dhe ndjek udhëzimet e komisionit vendor për emergjencat civile dhe kërkon mbështetjen e këtij komisioni.
- c. Vepron sipas planeve të perballimit të emergjencave, të hartuara më parë dhe të miratuara në këshillin bashkiak ose komunal, të cilat janë pjesë e planit të emergjencave të qarkut.
- d. Në rast se situata përkeqësohet dhe me mundësitë e mjetet që zotëron nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë ose të komunës të kërkojë mbështetje nga bashkitë ose komunat fqinjë dhe nga instancat më të larta shtetërore.
- e. Bashkëvepron me grupe vullnetarësh, të specializuar për perballimin e emergjencave, dhe me banorë, që shprehin dëshirën të përfshihen përkohësisht në strukturat e shërbimit të emergjencave civile të bashkisë/ komunës.

27. Drejtuesit e forcave vepruese të shërbimit të emergjencave civile, në nivel qendror dhe vendor, si dhe qendrat operacionale kryejnë detyrat dhe përgjigjen për zbatimin e planeve për perballimin e emergjencave civile, sipas niveleve përkatëse.

28. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe prefektet e qarqeve, institutet kërkimore e shkencore, organet e qeverisjes vendore, si dhe agjencite e subjektet e ndryshme, që kanë lidhje me planifikimin dhe perballimin e emergjencave civile, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO


Në mungesë dhe porosi

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
ERMELINDA MEKSI**

MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT

BEN BLUSHI

STEMA E SHERBIMIT TE EMERGJENCAVE CIVILE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 532 ,datë 1.8.2003

PËR
PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË
PLANIFIKIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, dhe të pikës I/1, të nenit 2, të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Departamenti i Planifikimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile është përgjegjës për:
 - a) bashkëpunimin me institucionet e tjera për hartimin dhe freskimin e Planit Kombëtar për Përballimin e Emergjencave Civile;
 - b) hartimin e planeve për plotësimin dhe freskimin e rezervave të emergjencave civile, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile;
 - c) menaxhimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe bashkërendimin e strukturave, shtetërore dhe joshitetërore, që lidhen me to;
 - d) përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e akteve nënligjore për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile;
 - e) organizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare për bashkëpunim, dypalësh dhe shumëpalësh, për problemet e emergjencave civile, mbrojtjen nga zjarri dhe të ndihmave humanitare;
2. Departamenti i Planifikimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile ka këto detyra:
 - a) Zbaton, së bashku me institucionet e tjera, politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e planifikimit për përballimin e emergjencave civile, të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe në krijimin, përdorimin dhe shpërndarjen e mallrave rezervë emergjente: ushqimore, materiale e monetare;
 - b) Bashkëpunon me institucionet dhe entet publike të vendit, për të bërë vlerësimin e situatave emergjente mbi të cilat bazohet Plani Kombëtar i Emergjencave Civile dhe organizon punën për freskimin e tij në mënyrë periodike;
 - c) Ndjek në vazhdimësi situatën e mbrojtjes nga zjarri dhe gjendjen e emergjencave civile në të gjithë territorin e vendit, në rajon dhe më gjërë dhe planifikon masa vepruese ndaj tyre ;
 - d) Planifikon fonde për studime nga entet publike për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile;
 - e) Në çdo 6 muaj përgatit raport për gjendjen e përgjithshme të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile;
 - f) I siguron Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile të gjitha të dhënat e nevojshme për situatat emergjente, për rreziqet që paraqesin, si dhe mundësitë për mbështetje materiale të operacioneve për përballimin e emergjencave civile;

- g) Planifikon dhe përcakton rregullat e përdorimit të burimeve, financiare e materiale, në rastet e emergjencave civile ;
 - h) Bashkërendon punën e institucioneve qendrore me organet e qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave civile ;
 - i) Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e strukturave, aktive dhe mbështetëse, të shërbimit të emergjencave civile;
 - j) Kërkon të dhëna për përballimin e emergjencave civile, duke komunikuar drejtëpërdrejtë me strukturat, e përhershme dhe të përkohshme, të shërbimit të emergjencave civile në nivel qendror, në nivel qarku dhe bashkie e komune ;
 - k) Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencave civile ;
 - l) Lidh marrëveshje me shoqata dhe organizma, që ofrojnë asistencë për realizimin e detyrave të planit, për përballimin e emergjencave civile dhe për krijimin e rezervave ;
 - m) Organizon dhe drejton konferenca, seminare dhe workshope për personelin e shërbimit të emergjencave në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor;
 - n) Përpunon dhe ndjek programet e edukimit publik dhe të trajnimit të strukturave, shtetërore dhe jo shtetërore në fushën e mbrojtjes civile ;
 - o) Udhëzon strukturat përgjegjëse për mënyrën e sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit të opinionit publik për emergjencat civile dhe mbrojtjen nga zjarri;
 - p) Bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe riaftësimin nga fatkeqesitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera, në përputhje me aktet, ligjore dhe nënligjore, përkatëse;
 - q) Kontrollon zbatimin e masave; mbrojtese dhe parandaluese, për përballimin e rasteve të emergjencave civile dhe mbrojtjes nga zjarri, pranë subjekteve, shtetërore dhe private, në të gjithë territorin e vendit;
 - r) Kontrollon mënyrën e përdorimit të burimeve, materiale e financiare, që vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit ose nga organe të tjera shtetërore, për rastet e emergjencave civile, për organet, qendrore dhe vendore;
 - s) Kontrollon shpërndarjen dhe mënyrën e përdorimit të mallrave rezervë emergjente, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, si dhe me aktet, ligjore dhe nënligjore, në fuq;
 - t) Organizon grupe ndërministrorë monitorimi për mënyrën e menaxhimit të sistemit të emergjencave civile.
3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Departamenti i Administratës Publike, pranë Këshillit të Ministrave, si dhe ministritë e linjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO

Në mungesë dhe porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERMELINDA MEKSI

**MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT**

BEN BLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 533, datë 1.8.2003

PËR

PJESËMARRJEN E SHTETASVE NË PARANDALIMIN DHE
PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 35 të ligjit nr.8756, datë 26.03.2001, "Për emergjencat civile", dhe të nenit 12, të ligjit nr. 8927, date 25.07.2002, "Për prefektin", me propozimin e ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Prefekti i qarkut, nëpërmjet zyrave të gjendjeve civile në bashki dhe komuna, siguron të dhëna dhe mban evidencë për shtetasit në territorin e qarkut, me moshë nga 18 deri në 55 vjeç për gratë dhe deri në 60 vjeç për burrat.
2. Prefekti i qarkut, nëpërmjet qendrave të rekrutim mobilizimit në qarqe, evidenton dhe siguron të dhëna për shtetasit të cilët gjatë shërbimit ushtarak janë specializuar në shërbime të mbrojtjes civile, operacionet e kërkim-shpëtimit, repartet xheniere, mbrojtjen nga armet e shkatërrimit në masë, mbrojtjen nga zjarri, shërbimin shëndetësor, si dhe specialitete të tjera të nevojshme, për përballimin e emergjencave civile.
3. Prefekti i qarkut, nëpërmjet drejtorive arsimore të rretheve, evidenton dhe siguron të dhëna për shtetasit, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë dhe janë specialistë të fushave përkatëse, si dhe planifikon përfshirjen e tyre në procesin e planifikimit, parandalimit dhe përballimit të emergjencave civile.
4. Në rastet e emergjencave civile, drejtuesi qendror i operacionit / drejtuesi i operacioneve në nivel qarku, i kërkon prefektit të qarkut angazhimin, sipas nevojave, të shtetasve të aftë. Prefekti i qarkut, në bashkërendim me kryetarin e bashkisë / komunës, urdhëron aktivizimin e shtetasve dhe planifikon përfshirjen e tyre pranë strukturave operacionale, që veprojnë për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e qarkut.
5. Kryetari i bashkisë / komunës, nëpërmjet zyrave të gjendjeve civile në bashki dhe komunë, siguron të dhëna dhe mban evidencë për shtetasit në territorin përkatës, me moshë nga 18 deri në 55 vjeç për grate dhe deri në 60 vjeç për burrat.
6. Kryetari i bashkisë / komunës, në rastet e emergjencave civile, me kërkesë të komisionit vendor të emergjencave civile në bashki / komunë, drejtuesit të operacioneve në nivel qarku, drejtuesit të operacioneve në nivel bashkie / komune, në bashkërendim me prefektin urdhëron angazhimin, sipas nevojës, të shtetasve të aftë në territorin përkatës të bashkisë / komunës dhe planifikon përfshirjen e tyre pranë strukturave vendore apo strukturave të tjera operacionale, që veprojnë për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e prekur nga fatkeqësia.

7. Kur shtetasi angazhohet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile mbi 8 orë në ditë dhe larg vendbanimit, sipas rastit prefekti i qarkut, kryetari i bashkisë / komunës, në bashkëpunim me strukturat operacionale dhe shoqatat humanitare, ku shtetasi është angazhuar, e trajtojnë me ushqim dhe fjetje.
 8. Asnjë drejtues operacioni nuk mund të detyrojë shtetasin e angazhuar në operacionet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, të ndërhyjë në situata apo vende ku rrezikohet jeta e shtetasit, si dhe ku / kur kërkohet kualifikim i veçantë.
 9. Në çdo rast, kur me urdhër të prefektit, kryetarit të bashkisë / komunës, shtetasi angazhohet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, atij i lëshohet dokument zyrtar, që vërteton angazhimin e tij në strukturën përkatëse.
 10. Dokumenti zyrtar, që vërteton pjesëmarrjen e shtetasit në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, detyron punëdhënësin, qoftë ky dhe subjekt privat, të garantojë vendin e punës, dhe pagesën e plotë.
- Në rastet e aksidenteve, institucionet përkatëse plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për përfitim të pensionit të invaliditetit, sipas legjislacionit në fuqi.
11. Për moszbatimin e urdhrat të prefektit të qarkut, dhe të kryetarit të bashkisë / komunës për pjesëmarrje të shtetasve në përballimin e situatave emergjente, zbatohen dispozitat e akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi.
 12. Prefekti i qarkut, në bashkëpunim me qendrat e rekrutim-mobilizimit në qarqe me drejtuesit e reparteve të Forcave të Armatosura në territorin e qarkut, me Stacionin e PMNZSH-së dhe OJF-të, programon dhe realizon trajnimin e shtetasve për situata të emergjencave civile.
 13. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes, prefektët e qarqeve dhe kryetarët e bashkive / komunave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO

Në mungesë dhe porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERMELINDA MEKSI

**MINISTRI I PUSHTETIT
VENDOR DHE I DECENTRALIZIMIT**

BEN BLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
Drejtoria e Pergjithshme e Emergjencave Civile

Tiranë, më 04.02.2003

UDHEZIM

Nr. 3 datë 04.03.2003

Për

“Kriteret e përzgjedhjes së personelit të strukturave të emergjencave civile”

Në zbatim të nenit 8, pika 2a dhe 2m, të Ligjit nr. 8756, dt, 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 655, dt. 18.12.2002, pika 7b, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

UDHEZON

Për përzgjedhjen e personelit, i cili do te punësohet në strukturat e emergjencave civile të zbatohen këto kriteret:

1. Të përgjithshme

- Të ketë aftësi për planizimin dhe menaxhimin e emergjencave civile në territorin dhe/ose fushën e veprimtarive të institucionit përkatës.
- Të ketë aftësi për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe atyre që vijnë si rezultat i veprimtarisë njerëzore, për territorin dhe/ ose fushën e veprimtarisë së institucionit përkatës
- Të ketë aftësi për të këshilluar drejtuesin e institucionit përkatës dhe për t’u angazhuar në zgjidhjen e problemeve për parandalimin, planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile, në territorin dhe apo/fushën e veprimtarisë së institucionit përkatës.
- Të ketë aftësi për të bërë vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave, në rastet e emergjencave civile.
- Të ketë aftësi për të bashkëpunuar me agjenci dhe institucione të tjra, në fushën e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile në territorin dhe/apo fushën e veprimtarive të institucionit përkatës.

2. Të veçanta

- Të jenë oficerë të dalë në rezervë, për shkak të reformës në forcat e armatosura ose policinë e shtetit dhe nga punëdhënësi i fundit të kenë vlerësime positive.
- Të jenë të diplomuar në Akademinë Ushtarake, Akademinë e Rendit Publik, ose në Universitetin e Tiranës, dhe titulluar oficer aktiv.
- Të kenë vjetërsi pune mbi 10 vjet, për përgjegjësit e sektorëve dhe zyrave, dhe mbi 5 vjet për inspektorët dhe specialistët.
- Të njohin dhe përdorin programet bazë në kompjuter.
- Të preferohen kandidatët që njohin gjuhën angleze, ose një gjuhë tjetër perendimore.
- Punonjësit e emergjencave civile duhet të jenë me vendbanim të njëjtë me vendndodhjen e institucionit përkatës.

3. Të tjera

a) Për Ministrinë

Testimi dhe vlerësimi për përzgjedhjen e personelit të çdo ministrie, të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8549, dt. 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" dhe sipas veçorive përkatëse që ka çdo ministri.

b) Për Administratën e Prefektit

- Në konkurim për një vend pune të jenë mbi katër kandidatë dhe ndër tre të parët, Prefekti ka të drejtën e përzgjedhjes së njërit prej tyre.
- Njoftimi për vendet e lira të punës në strukturat e emergjencave civile të bëhet në një nga gazetat e përditshme.

c) Për periudhën kalimtare

Punonjësit ekzistues të strukturave të emergjencave civile, në rast se plotësojnë kriteret e mësipërme në institucionet qendrore, administratat e Prefektëve dhe atë të Bashkisë së Tranës, kalojnë nëpunës të administratës civile për institucionet qendrore dhe nëpunës të administratës për institucionet e tjera, në periudhë prove 1 vjeçare.

Institucioni përkatës me emërimin e personelit të emergjencave civile të dërgojë në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, një informacion të përmbledhur, ku të përshkruhet ecuria e procesit dhe një CV e punonjësit të emëruar.

MINISTRI

Ben Blushi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR DHE DECENTRALIZIMIT
KABINETI

UDHEZIM

Nr. 15 datë 10.07.2003

Për

“Ngritjen e Komisionit Vendor të Emergjencave Civile, në Bashki dhe Komunë”

Në zbatim të pikës 2, të nenit 17, të ligjit Nr. 8756, dt. 26.03.2001, “Për Emergjencat civile”, dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 655, dt. 18.02.2002, “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile”, në shtojcën rekomandime, pika B, pika 3 e këtij vendimi,

UDHEZOJ

1. Për planifikimin, kordinimin dhe menaxhimin e emergjencave civile në territorin e bashkisë ose komunës, nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë ose Komunës ngrihet Komisioni Vendor i Emergjencave Civile, në bashki ose komunë.
2. Komisioni Vendor i Emergjencave Civile, kryesohet nga Kryetari i Bashkisë ose Komunës dhe ka në përbërje:

- Kryetari i Bashkisë/Komunës	kryetar.
- Punonjësi i ngarkuar për emergjencat civile në bashki/komunë	sekretar
- Përfaqësuesi i Komisarariatit të Policisë, që cili vepron në rajonin e bashkisë/komunës	anëtar
- Përfaqësuesi i Stacionit të PMNZSH-së, që vepron në rajonin e bashkisë/komunës	anëtar
- Komandanti i njësisë ushtarake më të madhe që vepron në territorin e bashkisë/komunës	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve Publike në Bashki	anëtar
- Përgjegjës për Shëndetin Publik	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Arsimit, Kulturës dhe Sporteve	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës Juridike	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës për Transportin dhe Industrinë	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Financës	anëtar
- Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Shqiptar	anëtar
- Përfaqësues nga OJF-të që veprojnë në rajon	anëtar

3. Në rast se në strukturën e Bashkisë ose Komunës, nuk ekziston struktura përkatëse, në përbërje të komisionit merr pjesë personi përgjegjës për këtë funksion.
4. Detyrat dhe mënyra e funksionimit të Komisionit Vendor të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, në nivel bashkie ose komune.

A. Detyrat

- a) Komisioni i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile në nivel bashkie ose komune, planifikon, organizon, kordinon dhe kontrollon të gjithë masat parandaluese, lehtësuese dhe rehabilituese për përballimin e emergjencave civile në territorin e bashkisë ose komunës.
- b) Komisioni harton dhe miraton planet e përballimit të emergjencave civile në territorin e vet dhe i dërgon ato për aprovim e kordinim tek Prefekti i Qarkut.
- c) Komisioni bashkëpunon me Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera si dhe riaftësimin e zonave të dëmtuara.
- d) Komisioni bashkërendon veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në raste emergjente.
- e) Komisioni evidenton burimet materiale dhe financiare shtetërore dhe joshtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në situata emergjente.
- f) Komisioni ndjek e zbaton urdhrat, udhëzimet dhe detyrat që i ngarkohen drejtpërdrejt ose me delegim nga strukturat qendrore të emergjencave civile.
- g) Komisioni jep informacion pranë Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile, në situata emergjente dhe ngarkon sekretarin e tij, për të dhënë informacion në periudhë normale.
- h) Komisioni përgatit dhe përpunon programe trainimi, me skenare situatash emergjente për përgatitjen e personelit që menaxhon emergjencat civile, si dhe të komunitetit.

B. Funksionimi

- a) Komisioni funksionon në situata normale dhe situata emergjente.
 - b) Organizimi, radha e mbledhjeve, takimeve, konsultave, rendi i ditës si dhe gjithë modalitetet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij, propozohen nga Kryetari dhe miratohen në mbledhjen e parë të Komisionit.
 - c) Komisioni mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj në situata normale, ose rast pas rasti sipas nevojës, si dhe qendron i mbledhur kur shfaqen situata të emergjencave civile.
 - d) Sekretari i komisionit, për përgatitjen e të gjithë materialeve të mbledhjeve të radhës së komisionit.
5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Kryetarët e Bashkive dhe Komunave.

MINISTRI

Ben Blushi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR DHE DECENTRALIZIMIT
KABINETI

UDHEZIM

Nr. 16 Datë 11.07.2003

Për

“Ngritjen e Komisionit të Planifikimit të Emergjencave Civile në Nivel Qarku”

Në zbatim të neneit 13, pika 2, të ligjit Nr. 8756, dt. 26.03.2001, “Për emergjencat Civile”, si dhe të pikës 5/a, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 655 dt. 18.12.2000, “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile”, me qëllim planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në nivel qarku,

UDHEZOJ

1. Për planifikimin dhe kordinimin e të gjithë institucioneve shtetërore dhe agjencive të tjera që veprojnë në qark për përballimin e emergjencave, nën drejtimin e prefektit ngrihet Komisioni i Planifikimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile në nivel qarku.
2. Përbërja e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në qark të jetë:

- Prefekti	kryetar
- Kryetar i Këshillit të Qarkut	n/kryetar
- Përgjegjësi i Zyrës së Emergjencave Civile	sekretar
- Nënprefekti	anëtar
- Sekretar i Përgjithshëm	anëtar
- Drejtor i Policisë së Qarkut	anëtar
- Komandanti i Njësisë Ushtarake në territorin e qarkut	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve në administratën e Prefektit	anëtar
- Përgjegjësi i Sektorit të PMNZSH-së	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Arsimit, Kulturës dhe Shëndetësisë	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës Juridike	anëtar
- Përgjegjësi i Zyrës së Kordinim Zhvillimit	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Arkivit dhe Gjendjes Civile	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës së Financës	anëtar
- Përgjegjës i Zyrës Rajonale të Turizmit	anëtar
- Drejtori i Shërbimit Shërbimit Shëndetësor në rreth	anëtar
- Drejtori Rajonal i Mirëmbajtjes së Rrugëve Nacionale	anëtar
- Drejtori Rajonal i Ujësjellës-Kanalizimeve	anëtar
- Drejtori Rajonal i Tatim Taksave	anëtar
- Drejtori Rajonal i Doganave	anëtar
- Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, në qark	anëtar
3. Detyrat dhe mënyrat e funksionimit të Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel qarku:

- a) Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel qarku planifikon, kordinon dhe kontrollon të gjitha masat parandaluese, lehtësuese dhe rehabilituese për përballimin e emergjencave civile në territorin e qarkut.
- b) Komisioni ka për detyrë të hartojë dhe miratojë, planet e përballimit të emergjencave civile në nivel qarku dhe t'i dërgojë për aprovim e kordinim në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.
- c) Komisioni jep informacion pranë Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile, në situatë emergjente dhe ngarkon sekretarinë tij për të dhënë informacion në periudha normale.
- d) Komisioni bën përpunimin e të gjithë të dhënave për resurset që ka në qark, bazën materialo-teknike nën administrimin shtetëror dhe privat dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në situata emergjente.
- e) Komisioni përgatit dhe përpunon programe trainimi, skenare për situata emergjente, për përgatitjen e personelit që menaxhon emergjencat civile si dhe të komunitetit.
- f) Komisioni mbështet drejtuesin e operacionit në nivel Qarku për manaxhimin e emergjencave civile.
- g) Komisioni bashkërendon veprimtaritë në organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në raste emergjente.
- h) Komisioni bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe me institucione të tjera, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera dhe riaftësimin e zonave të dëmtuara.

4. Funksionimi:

- a) Komisioni funksionon në situata normale dhe në rast situatë emergjente.
- b) Mënyra e organizimit, radha e mbledhjeve, takimeve, konsultimeve, rendit të ditës, përcaktohet nga prefekti.
- c) Komisioni mbidhet jo më pak se një herë në tre muaj për situata normale, ose rast pas rasti sipas nevojës, si dhe qendron i mbledhur kur shfaqen situata të emergjencave civile, sipas përbërjes që përcakton Prefekti i Qarkut.
- d) Komisioni në mbledhjen e parë përcakton modalitetet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij dhe harton rregulloren e funksionimit të komisionit.
- e) Sekretari i Komisionit mban përgjegjësi për përgatitjen e materialeve dhe aktiviteteve të komisionit.

Për zbatimin e këtij udhëzimi, përgjigjen Prefektët dhe Kryetarët e Këshillave të Qarqeve. Ky udhëzim hyn në fuqi nga data e daljes së tij.

MINISTRI

Ben Blushi